



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 672/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të ndërhyrje e personave të paautorizuar në vendvotim, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.672/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të ndërhyrjes së personave të paautorizuar në vendvotim Nr.2121B/02D.

### A r s y e t i m

Me datë 18.10.202, PZAP, ka pranuar ankesë nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari,, me të cilën pretendon se: në vendvotimin nr.2121B/02D, në shkollën fillore “Kuvendi i Drenicës”, pes minuta pas mbylljes së votimit, kanë hyrë dy përsona të paautorizuar të cilët kanë krijuar dyshime të bazuara për manipulime në procesin e numrimit të votave. Gjithashtu kërkon nga PZAP , të bëjë hetim sa i përketë këtij vendvotimi.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij në ankesë. Paneli konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, duke i siguruar deklaratat nga Kryesuesi i Qendrës së Vendvotimit Shefqet Koci, me të cilin thekson se: *“ne qendrën e votimit ne Abri te Poshtme me nr 2121b/02D. Deklaroi se ne ketë vendvotim nuk ka pas asnjë parregullsi rreth ankesës se parashtruar . Un si kryesues i vendvotimi ne orën 19:00 pasi jam sigurua nga menaxherja e shkollës qe nuk ka asnjë person duke pritur ne radhë për te votuar, kam mbyllur derën e votimit dhe kemi filluar me numërimin e votave. Deklaroi se deri ne momentin e numërimit te gjitha votave dhe mbylljen e kutive në vendvotim nuk ka hyrë asnjë person përvçe 4 Anëtareve te subjekteve politike dhe vëzhguesve te partive , për ketë jam ne gjendje te përgjigjem ne çdo rast dhe kohë, po ashtu nuk ka pas asnjë ankesë as nga ndonjë anëtar i ndonjë subjekti politik dhe as nga ndonjë vëzhgues . Rreth kësaj qe kam deklaruar mund ti*

*pyetni edhe anëtarët tjerë që kanë qenë nga subjektet tjera politike*”, si dhe deklaratën e Drejtoreshës së Shkollës Ariana Hasani, me të cilën ka theksuar se: “*nuk ka pasur parregullsi dhe se mohon që Fazli Qerkini dhe Latif Smakiqi, janë futur në vendvotimin 2121B/02D*”. Prandaj nga këto deklarata rezulton fakti se nuk ka pasur parregullsi ashtu siç pretendon pala ankuese në ankesë.

Paneli i shqyrtoi edhe deklaratat e bashkangjitura me ankesë nga ankuesi mirëpo të njejtave nuk ua fali besimin sepse pretendimet nga ankesa te pa mbështetura ne prova mbesin pretendime në nivelin e supozimeve, e po ashtu te njëjtat ishin në kundërshtim me deklaratat e kryesuesit të vendvotimit dhe të Drejtoreshës së Shkollës, të cilët në mënyrë kategorike mohuan se ka pasur parregullsi. Andaj nga një konstatim i tillë, duke u mbështetur në deklaratat e kryesuesit të vendvotimit dhe Drejtoreshës së Shkollës dhe në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, ne mungese të të provuarit me prova ku barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e që në rastin konkret, ankuesi nuk ka paraqitur prova, sipas përshkrimit të ankesës paneli, refuzoi ankesën si të pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e Lista e Pavarur – Bekim Jashari, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës ka mospërputhje në mesë të pretendimeve në ankesë dhe dëshmive të dëshmitarëve të lartcekur.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa**  
Anr.672/2021 më datën 20.10.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.